



VENDIM
Nr.20 Datë 08.03.2010
PËR
SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TE
VENDOSURA NGA ERE SHOQËRISË “BIOPOWER GREEN
ENERGY” SH.P.K

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, gërma “a”, dhe 15 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të Ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.03.2010, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorise se Licensimit dhe Monitorimit të Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “BIOPOWER GREEN ENERGY” sh.p.k,

Dhe duke konsideruar :

Kompleksitetin e problematikes që i licensuari ka hasur për fillimin e punimeve për ndërtimin e centraleve, me erë “BPGE 1” dhe “BPGE 2” për shkak se ende nuk ka marrë autorizimin e Linjës Tregëtare nga pala Italiane, duke qene se ndertimi i linjave të interkonjeksionit, pervec etapave administrative ne te cilat kalon cdo projekt perben akoma nje teknologji jo shume te njohur ne vend dhe qe kerkon asistencen teknike te huaj,

Për gjithë sa më sipër,

Vendosi:

1. Në vendimin nr.90, datë 06.08.2008, për dhenien e licensës shoqërisë ”Biopower Green Energy” sh.p.k në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike si dhe prodhimin e energjisë elektrike, nga parqet Eolik “BPGE 1” dhe “BPGE 2”, të bëhen këto ndryshime:

Pika 1 gërma “e” të ndryshohet si më poshtë:

e.1 Afati i fillimit të punimeve për realizimin e projektit do të jetë deri në 18 muaj në përputhje të afatit të përcaktuar ne lejen e METE-s nr. 4/1, datë 07.12.2009, të miratuar me VKM nr. 31, datë 20.01.2010, për ndërtimin e Linjës Tregëtare të Interkonjeksionit.

e.2 Koha e zbatimit të gjithë projektit përfshirë dhe kolaudimin e veprës do të jetë 36 muaj nga realizimi i afatit të përcaktuar ne pikën e.1.

2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë “Biopower Green Energy” për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s
Bujar Nepravishta**

Adresa: Blvd "Gjergj Fishta" Nr.10
963
Tirane
69 590
E-mail erealb@ere.gov.al

Tel/Fax +355 42 22

Tel +355 42

www.ere.gov.al